



REPUBLIKA E KOSOVES	REPUBLIC OF KOSOVO
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCES	AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY	
Nr.i Prot./Br. Prot./Prot.No.	138/18-02/D
Nr.i Fq./Br. St./No.Pg.	715
Data/Datum/Date:	30.03.2018
PRISHTINE-PRISTINA-PRIŠTINA	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës  
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Datë: 30.03.2018

Mbështetur në nenin 28, neni 29, paragrafi (1), neni 54, paragrafi (1) me nën paragrafin 1.7, neni 3, paragrafi (1.2), (1.8), neni 4, neni 35, neni 36, neni 46, i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka filluar procedurën hetimore ndaj Furrtarëve të Komunës së Pejës me dyshimin për marrëveshje të ndaluar apo praktik të bashkërenduar për fiksimin/ngritjen e çmimit të bukës standarde, në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2018 merr këtë:

**V E N D I M**

- I. AUTORITETI –Përfundon procedurën sipas konkluzionit nr. prot. 232/17-02/B. i datës 05.10.2017.
- II. AUTORITETI PRANON – marrjen e detyrimeve nga Furrtarët e Komunës së Pejës, se çmimi i bukës standarde do të caktohet në bazë të ofertës dhe kërkesës në treg.
- III. AUTORITETI – do të ri iniciojë procedurën kur në mënyrë të konsiderueshme janë ndryshuar rrethanat në të cilat është bazuar Autoriteti për marrjen e vendimit.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

**A R S Y E T I M**

Autoritetit Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare me datën 25 dhe 26.09.2017, ka autorizuar inspektorët hetues që të monitorojnë tregun në Komunën e Pejës lidhur me dyshimin për marrëveshje të ndaluar në mes Furrtarëve për fiksimin/ngritjen e çmimit të bukës nga 0.30 cent në 0.40 cent.

## TREGU PËRKATËS APO RELEVANT

**Tregu gjografik** - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2011, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu **gjografik konsiderohet regjioni i Komunës së Pejës**.

### Tregu i produktit është:

Tregu i produktit konsiderohet shitja e bukës standarde.

Autoritetit Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare, pas shqetësimeve të ngritura nga Komuna e Pejës dhe konsumatorët me datën 25 dhe 26.09.2017, ka autorizuar inspektorët hetues që të inspektojnë Furrat në Komunën e Pejës me dyshimin se kanë arritur marrëveshje përfiksimin/ngritjen e çmimit të bukës standarde. Inspektorët hetues me datën 25.09.2017 dhe 26.10.2017 kanë kontaktuar me zyrtar kompetent të Komunës së Pejës Zyrtarët komunal brenda fushëveprimit dhe kompetencave ligjore kanë pohuar se kanë mbajtur një takim me furrtarë mirëpo nuk kishin gjetur mirëkuptim që çmimi i bukës standarde të zbritet në 0.30 cent nga 0.40 cent.

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në Mbledhjen e mbajtur më 05.10.2017 ka marrë KONKLUZION përfillimin e procedurës hetimore ndaj Furrtarëve dhe Shoqatës së Zejtareve, Hotelierëve dhe Afaristëve të Komunën së Pejës, me nr. prot. 232/17-02/B, lidhur me dyshimet përmarrëveshje të ndaluar në mes furrtarëve përfiksimin/ngritjen e çmimit të bukës standarde nga 0.30 cent ne 0.40 cent.

Në Autoritet janë dorëzuar dy Parashtresa nga pronari i Furrës "Liria" dhe pronari i Furrës "Dielli 2". Pronari i Furrës "Liria", ka deklaruar se ka qenë detyruar ta rikthej çmimin e vjetër i cili ka qenë 0.40 cent deri në qershori të vitit 2016. Ndërsa rikthimi i çmimit të bukës standarde është bërë përfaktin se në janar të vitit 2016, çmimi përfshirë një kilogram miell ka qenë 0.2180 cent, dhe ka filluar të ngritet gradualisht ku në gusht të vitit 2017, 1 kg miell është ngritur deri më 0.2944, cent dhe ende ka ngritje, këtu duket përfshirë edhe rritja e çmimit të energjisë elektrike dhe drunjëtë dhe ka qenë e pashmangshme që të mos rikthehet çmimi i vjetër i bukës në treg dhe sa i përket çmimit të rritur të bukës nuk kam bërë marrëveshje me askënd dhe këtë e kam bërë në bazë të rritjes së çmimeve të cekura më lart, deklaram të ngjashëm ka dhënë edhe pronari i Furrës "Dielli 2".

Autoriteti pas disa takimeve të mbajtura me pronarët e furave të kësaj komune ka shpjeguar dispozitat e Ligjit përfshirë Mbrojtjen e Konkurrencës, lehtësirat të cilat dalin nga neni 46 përmarrjen e detyrimeve nga ndërmarrjet përfshirë rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, pas këtyre takimeve Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me datën 16.02.2018, me nr. të prot. 72/18-01/H, ka pranuar një shkresë nga 13 furrtar të Komunës së Pejës me të cilin kanë deklaruar se:

*Pas konsultimit me inspektorët hetues të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe konsultimit me Ligjin përfshirë Mbrojtjen e Konkurrencës, ju njoftojmë se mënyra e përcaktimit të çmimeve të bukës do të bëhet në bazë të ofertës dhe kërkesës në treg, përmes kësaj shkresë e njoftojmë Autoritetin*

*Kosovarë të Konkurrencës se do t'i marrim detyrimet që dalin nga nen 46 i Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.*

### **Vlerësimi i të dhënave gjatë procedurës hetimore dhe analiza e konkurrencës**

Pronarët e furrave në Komunën e Pejës me datën 18.08.2017, kanë mbajtur mbledhje në qendrën tregtare Zejtare Iliriana dhe në këtë takim është diskutuar për ngritjen e çmimit të bukës. Në këtë takim nuk kanë arritur Marrëveshje për rritjen e çmimit, mirëpo fiksimi/ngritja e çmimit të bukës është bërë në takimin e dytë në restorant “Delta” në Pejë. Ky takim ka ndodhur orientimisht me datën 25.08.2017. Në këtë Mbledhje kanë rënë dakord që nga data 1 shtator 2017, të ngritet çmimi i bukës nga 0.30 në 0.40 cent. Gjatë shqyrtimit paraprak në tregun relevant AKK-se ka vërejtur se në të gjithat furrat e Komunës së Pejës çmimi i bukës kishte ngritje nga 0.30 cent ne 0.40 cent.

Me shkresën e datës 16.02.2018, të 13-të furrtar të Komunës së Pejës kanë marrë për sipër se mënyra e përcaktimit të çmimeve do të bëhet në bazë të ofertës dhe kërkesës në treg, këto detyrime i kanë marrë për t'i eliminuar efektet negative të veprimeve dhe lëshimeve në konkurrencën tregtare.

Autoriteti për t'i vërtetuar zotimet e furrtarëve ka monitoruar tregun në Komunën e Pejës me të cilin ka siguruar dëshmi se tregu është konkurruesh, çmimi i bukës standarde është i ndryshëm duke filluar nga çmimi 0.30 cent, 0.33 cent, 0.35 cent, 0.37 cent, dhe 0.40 cent.

AKK vlerëson se në tregun përkatës masat e propozuara nga të 13-të furrtar të Komunës së Pejës kanë marrë për sipër se mënyra e përcaktimit të çmimeve do të bëhet në bazë të ofertës dhe kërkesës në treg, këto detyrime i kanë marrë për t'i eliminuar efektet negative të veprimeve dhe lëshimeve në konkurrencën tregtare.

AKK konstaton se kërkesa e furrtarëve dhe dëshmitë që i posedon AKK janë të mjaftueshme për të eliminuar efektet negative dhe rivendosjen e konkurrencës në treg, dhe bëhen të detyrueshme për propozuesit sipas nenit 46, Paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës vepron për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, me ç ‘rast do të vinte në shprehje edhe interes i konsumatorit në veçanti, me synimin final që tregu të gjenerojë zhvillim, mundësi zgjedhje, zëvendësueshmëri të produktit apo shërbimeve dhe garë ndërmjet operatorëve ekonomik.

**Këshilla juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicioj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.*

Me këtë VENDIM të njoftohen:

- Arhiva
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Palët
- Komuna e Pejës

AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS

KOMISIONI I KOSOVARE ZA KONKURRENCË



Valon PRESTRESHI

Kryetar

Fatime HAZIRI

Anëtare

Shaqir MORINA

Anëtar

Muhamed KRASNIQI

Anëtar

  
Ahmet KRASNIQI  
Zv. Kryetar





